



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITETI  
"HASHTI ZEKA"

## SYLLABUS i Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis
Titulli i lëndës:	Gjuhë Angleze II
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	VITI II / SEMESTRI IV
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FTMHM
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Asoc. Lirak Karjagdiu
Detajet kontaktuese: Celulari:	<a href="mailto:lirak.karjagdiu@uni-pr.edu">lirak.karjagdiu@uni-pr.edu</a>
Asistenti i lëndës:	MSc. Libron Kelmendi
Detajet kontaktuese:	libronkelmendi@hotmail.com
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Gjuha angleze II është një kurs praktik dhe teorik i cili synon zhvillimin e aftësive të studentëve në aftësitë receptive (të dëgjuarit dhe të lexuarit) dhe aftësitë produktive (të folurit dhe të shkruarit). Edhe pse qëllimi kryesor i këtij kursi do të jetë zhvillimi i aftësive komunikuese, kursi do të integrojë aspekte të tjera të gjuhës, si gramatika, fonetika. Kursi fokusohet gjithashtu në përmirësimin e rrjedhshmërisë së studentëve, një fjalor më të madh dhe aftësinë për të shprehur veten duke përdorur struktura më komplekse fjalish.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi i kësaj lënde është që: <ul style="list-style-type: none"><li>• t'u mundësojë studentëve të zhvillojnë dhe avancojnë aftësitë funksionale të gjuhës angleze;</li><li>• të zgjerojnë njohuritë e tyre gjuhësore dhe metagjuhësore;</li><li>• të rrisë besimin dhe aftësinë e studentëve për të komunikuar me folës të gjuhës angleze amtare dhe jo-amtare si në të folur ashtu edhe në të shkruar;</li><li>• motivojë studentët për t'u bërë mendimtarë kritikë dhe mësim nxënës të pavarur.</li></ul>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të: <ol style="list-style-type: none"><li>1. përshkruajnë aspekte të ndryshme të sistemit gjuhësor që</li></ol>

	<p>lidhen me morfologjinë, sintaksën dhe rregullat e fjalëformimit që rregullojnë anglishten;</p> <p>2. shkruajnë fjalë, fjali, shprehje dhe informacione për veten e tyre, të përshkruajnë gjëra dhe veprime të njohura dhe të përditshme, të shkruajnë letra të zakonshme, të shprehin pikëpamjet e tyre dhe gjithashtu të shkruajnë ese dhe punime të ndryshme në anglisht;</p> <p>3. lexojnë, diskutojnë dhe shkruajnë tekste dhe kumtesa, të cilat përmbajnë terminologji nga fushat dhe lëndët që mësojnë.</p> <p>Të gjitha këto aftësi do të mësohen dhe përvetësohen të ndërthurura dhe të ndërthurura me njëra-tjetrën sipas metodës direkte dhe ndërvepruese.</p>
--	---

--

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	1	3	3
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet, prezantimet ,etj			
<b>Totali</b>			<b>125/25=5 ECTS</b>

--

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Metodologjia e mësimdhënies së kësaj lënde do të jetë interaktive, me në qendër studentin. Një qasje mësim-praktikë-përdorim do të ju mundësoje studentëve që të bëhen funksionalë në gjuhën angleze. Qëllimet e lëndës do të arrihen përmes diskutimit të temave, përmes prezantimeve të studentëve, detyrave, punës në çifte dhe grupe që do të rezultojë në pasurimin e fjalorit të hotelerisë dhe turizmit, fjalor i nevojshëm për nevojat e studentëve. Prandaj, pjesëmarrja aktive e studentëve do të jetë thelbësore për përmbushjen e qëllimeve lëndore, si dhe për arritjen e rezultateve të të nxënit.</p>
-------------------------------------	---

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<table border="1"> <tr> <td>Punimi seminarik</td> <td>Deri në 10 pikë dhe këto pikë vlerësohen në totalin e pikëve nga kollokviumi dhe provimi përfundimtar.</td> </tr> <tr> <td>Kollokviumi</td> <td>50% e pikëve të mundshme + 1 pikë</td> </tr> </table>	Punimi seminarik	Deri në 10 pikë dhe këto pikë vlerësohen në totalin e pikëve nga kollokviumi dhe provimi përfundimtar.	Kollokviumi	50% e pikëve të mundshme + 1 pikë
Punimi seminarik	Deri në 10 pikë dhe këto pikë vlerësohen në totalin e pikëve nga kollokviumi dhe provimi përfundimtar.				
Kollokviumi	50% e pikëve të mundshme + 1 pikë				

		kërkohen për ta konsideruar të suksesshëm kollokviumin dhe pikët e arritura i shtohen pikëve të arritura nga provimi përfundimtar.
	<b>Provimi përfundimtar</b>	<b>Për ta konsideruar provimin të suksesshëm kërkohen 50% të pikëve të mundshme +1 pikë. Në vlerësimin përfundimtar shtohen pikët nga punimi seminarik dhe kollokviumi.</b>
	<b>Nota përfundimtare</b>	<b>51-60% - 6 61-70% - 7 71-80% - 8 81-90% - 9 91-100% -10</b>

<b>Literatura bazë:</b>	Brown, Steve and Salvatore Attardo. 2014. Understanding Language Structure, Interaction, and Variation. University of Michigan Press. Third edition. Swan, M., & Walter, C. (2001). The Good grammar book: A grammar practice book for elementary to lower-intermediate students of English. Oxford: Oxford University Press.
<b>Literatura shtesë:</b>	Walker, R., Harding, K., & Oxford University Press. (2015). Oxford English for careers: Tourism 3 : student's book. Oxford: Oxford University Press. Kalnins, S., & Zayat, J. (2014). Communicating with grammar: Skills for life. Berry, R. (2018). English grammar. Murphy, R. (2009). Essential grammar in use: A self-study reference and practice book for elementary students of English. Cambridge: Cambridge University Press. Greenbaum, Sidney and Randolph Quirk. 1999. A Student's Grammar of the English Language. Longman.

<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Hyrje në lëndën, tekstin mësimor, planprogramin, ligjeratat dhe ushtrimet, detyrat, kollokviumin, provimin përfundimtar.
<b>Java e dytë:</b>	Pjesët e ligjërates në Gjuhen Angleze
<b>Java e tretë:</b>	Ndajfolja
<b>Java e katërt:</b>	Emri
<b>Java e pestë:</b>	Nyjat dhe përcaktuesit; përdorimi me emra të numërueshëm dhe të panumërueshëm që shprehin cilësi apo zakone..
<b>Java e gjashtë:</b>	Mbiemri
<b>Java e shtatë:</b>	Përemri
<b>Java e tetë:</b>	Fjalja: Klasifikimi sipas ndërtimit
<b>Java e nëntë:</b>	Fjalitë e përbëra me bashkërenditje; Lidhëzat bashkërenditëse.

<b>Java e dhjetë:</b>	Fjalitë e përbëra me nënrenditje; Lidhëzat nënrenditëse.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Fjalitë kushtore: Llojet e fjalive kushtore.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Diateza veprorë dhe pësore.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë: Fjalitë deklarative, pyetëse dhe urdhërore në ligjëratën e drejte dhe të zhdrejtë.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Frazat foljore dhe parafjalët: Llojet e frazave foljore dhe të parafjalëve
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Rekapitullim i lëndës.
<b>Java</b>	<b>Ushtrimi që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Hyrje në lëndën, tekstin shkollor, aktivitetet praktike dhe metodologjinë.
<b>Java e dytë:</b>	Hyrje në 8 pjesët e ligjëratës.
<b>Java e tretë:</b>	Elaborimi i 5 llojeve të ndajfoljes. Ushtrime mbi shkallët e ndajfoljes, ndajfoljet e shpeshtësisë, mënyrës, vendit dhe kohës.
<b>Java e katërt:</b>	Ushtrime: Emrat e përveçëm, të përgjithshëm, emrat abstrakt, emrat kolektiv. Njëjësi dhe shumësi i emrit. Emrat e numërueshëm dhe të panumërueshëm.
<b>Java e pestë:</b>	Nyja e caktuar dhe të pacaktuar.
<b>Java e gjashtë:</b>	Formimi i mbiemrave. Ushtrime mbi shkallën krahasimore të mbiemrit.
<b>Java e shtatë:</b>	Ushtrime mbi llojet e përemrit.
<b>Java e tetë:</b>	Hyrje tek fjalitë në gramatikën e anglishtes.
<b>Java e nëntë:</b>	Identifikimi i lidhëzave bashkërenditëse dhe ndërtimi I fjalive të përbëra me bashkërenditje.
<b>Java e dhjetë:</b>	Identifikimi i lidhëzave nënrenditëse dhe ndërtimi I fjalive të përbëra me nënrenditje.
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Ushtrime mbi 3 llojet e fjalive kushtore.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Diateza veprorë dhe pësore. Ushtrime mbi ndryshimin e diatezës.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Ndryshimi i kohës së foljes në ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë. Identifikimi i llojit të fjalisë pyetëse. Rikrijimi i fjalive pyetëse.
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Përdorimi korrekt i parafjalëve. Identifikimi i frazave foljore.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Rekapitullim i temave.

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studenti është i detyruar të respektojë institucionin duke zbatuar të gjitha rregullat e përcaktuara të arsimit; Studenti është i detyruar të marrë pjesë aktive në ligjërata dhe ushtrime; Studenti nuk duhet të hyjë në klasë nëse janë vonë ose planifikojnë të largohen më herët nga mësimi; Gjatë diskutimeve në klasë ata duhet të respektojnë njëri-tjetrin, të jenë tolerantë ndaj mendimeve të kundërta, të parandalojnë gjykimin dhe ofendimin, të shprehin lirshëm mendimet e tyre, por të jenë të kujdesshëm dhe tolerantë ndaj mendimeve të nxënësve të tjerë.